

REKOMANDIMET

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës V (Tregtia dhe Çështjet Ekonomike)

Sesioni 3, Tema: Barrierat në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe njohja e kualifikimeve profesionale me BE (Kapitulli 3) *e martë, 20 tetor 2022, 10:30 – 11:30*

Kapitulli 3 i acquis së BE-së, trajton 3 fusha të përgjithshme ku përfshihen: 1. e drejta e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime; 2. njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale; 3. shërbimet postare. Për sa i përket të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, ky kapitull synon të sigurojë lirinë e ofrimit të shërbimeve ndërkufitare dhe mospengimin prej legjislacioneve kombëtare. Këtu përfshihen veprimtaritë industriale, artizanale dhe aktivitetet tregtare, gjithashtu aktivitetet që zhvillohen nga persona të vetëpunësuar. Më tej, siguron njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe diplomave mes shteteve anëtare, si dhe për disa profesione të rregulluara dikton që duhet të ndiqet kurrikula e zakonshme minimale e trajnimit në mënyrë që kualifikimi të njihet automatikisht në një shtet anëtar të BE-së.

Sipas raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2022, rekomandohet finalizimi i shqyrtimit të legjislacionit ekzistues për të identifikuar pengesat për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve me synimin për të përafuar më tej legjislacionin e tij me Direktivën e Shërbimeve. Në lidhje me njohjen e kualifikimeve, duhet të shtohen përpjekjet për të harmonizuar legjislacionin me acquis të BE-së dhe të sigurojë kapacitetin e duhur institucional në fushën e njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale.

Përgjatë sesionit 3 të GPV u trajtua tema “Barrierat në kuadër të lirisë së ofrimit të shërbimeve dhe njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale me BE”, ku i ftuar në cilësinë e ekspertit ishte Ondrej Blažo, Drejtor i Institutit të së Drejtës Europiane në Universitetin Komenius Brastislavë. Gjatë prezantimit të ekspertit dhe diskutimit me të pranishmit dolën në pah disa rekomandime se si mund të optimizohet procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit kombëtar për të arritur një harmonizim të suksesshëm.

Liria e Ofrimit të Shërbimeve

- *Eksperti këshillon që tani që procesi i negociatave ka nisur, Shqipëria duhet të nxitojë në punën përgatitore duke u njohur jo vetëm me praktikat e mira të shteteve anëtare, por edhe me punën e institucioneve si Gjykata Europiane e Drejtësisë apo Komisionit Europian, në mënyrë që të shmangen shkeljet apo implikime të tjera negative. Kjo do të ndihmojë gjithashtu që procesi screening’ të sjellë rezultatet e duhura dhe përshpejtimin e mbylljes për kapitullin 3.*

- Gjatë shqyrtimit të legjislacionit ekzistues - për të identifikuar barrierat me qëllim përafrimin me Direktivën e Shërbimeve duhet mbajtur në mendje **interpretimi i ngushtë që Gjykata Europiane e Drejtësisë** ka bërë lidhur me pengesat dhe kufizimet që nuk lejohen nga legjislacioni evropian për të shmangur probleme të mëvonshme. Këtu eksperti përmend çështjen C-625/17 - Vorarlberger Landes- und Hypothekenbank, ku gjykata është shprehur se kufizimet në lirinë për të ofruar shërbime përfshijnë jo vetëm masat kombëtare që ndalojnë, pengojnë por edhe ato që e bëjnë **më pak tërheqës ushtrimin e kësaj lirie**. Gjithashtu duhet konsideruar edhe **liria "pasive"** për të ofruar shërbime, përkatësisht lirinë për marrësit e shërbimeve për të shkuar në një shtet tjetër anëtar për të marrë një shërbim atje, pa u penguar nga kufizimet.
- Legjislacioni evropian vepron si një **udhëzues** për shtetet anëtare, duke vendosur **standardet 'dyscheme'** apo minimale që duhen respektuar domosdoshmërisht. Kur hartohen akte normative të reja, apo amendohen ato ekzistuese, shtetet në proces anëtarësimi, duhet të kenë si qëllim, njësimin me këto standarde kur vetëm është e nevojshme dhe në nivelin e përcaktuar.
- Eksperti këshillon **kujdes në transpozimin "copy paste"** të Direktivës së Shërbimeve, pasi ka një fushë të gjerë veprimi dhe mund të sjellë ngatërresa apo kosto të shtuara për amendimin e legjislacioneve ekzistuese që prek. Kjo ndodhi në Sllovaki, ku transpozimi me një akt të vetëm të direktivës çoi në amendimin e 37 akteve të tjera ligjore. Përsëri, eksperti nënvizon se direktiva mund të përdoret më efektivisht si një udhëzues për të evidentuar normat që i mungojnë rendit ligjor ekzistues dhe përfshirjen e tyre për të patur përputhshmëri me *acquis* të BE-së.
- Liria e ofrimit të shërbimeve është një fushë shumë **komplekse dhe e fragmentuar** në BE, po ashtu edhe në Sllovaki. Kjo rezultoi në një proces të ndërlikuar të njësimin të legjislacioneve sllovaqe me ato evropiane. Eksperti këshillon që puna në Shqipëri duhet të fillojë që tani, të identifikohet legjislacioni kombëtar që do të duhet të amendohet dhe çfarë duhet hartuar, si dhe hartimi i çdo akti të ri duhet bërë duke patur në mendje legjislacionin evropian.
- Duhet treguar kujdes në **ndryshimet** që duhen bërë, akte të reja ligjore që duhen miratuar për të siguruar jo vetëm përmbushjen e kërkesave të BE-së, por që edhe puna të jetë **cilësore dhe efikase**.
- Duhet treguar **kujdes** në miratimin e legjislacioneve të reja apo në fusha të tjera, se si prekin dhe ndërveprojnë me lirinë e ofrimit të shërbimeve (apo çdo liri tjetër), pasi edhe **dispozitat me natyrë diskriminuese** për ofruesit e jashtëm **apo favorizuese** për vendasit janë të ndaluara. Një eksperiencë të tillë pati Sllovakia me aktin ligjor nr.91/2019, i cili kërkonte që të paktën ½ e reklamave të çdo forme për produktet ushqimore dhe bujqësore duhet të jenë me origjinë sllovaqe. Këtu GjED gjeti shkelje jo vetëm të lirisë për të ofruar shërbime (reklamimi), por edhe të lëvizjes së lirë të mallrave dhe lirisë së vendosjes.

- Që reformat dhe ndryshimet në legjislacion të sjellin efektet e dëshiruara, eksperti këshillon që të llogariten **periudha tranzicioni të mjaftueshme** për ato çështje të cilat janë më të ndërlikuara dhe

që kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe kohë për tu arritur. Kjo do të ndihmojë në përshtatjen më organike të shoqërisë shqiptare me ndryshimet ekonomike dhe politike që do të pasojnë.

Njohja e Ndërsjellë e Kualifikimeve Profesionale dhe Diplomave

- Duhet të hartohet një **udhërrëfyes për masat konkrete** që duhet të ndërmerren për profesionet e rregulluara, si dhe të forcohen kapacitetet institucionale në këtë fushë.
- Ndikimi i planifikuar për njohjen e kualifikimeve dhe rregullimin e profesioneve është për të krijuar lehtësira për ofrimin ndërkufitar të tyre, megjithatë ndikimi shkon përtej objektivave të BE-së, duke sjellë përfitime edhe për profesionistët vendas. Ndaj duhet të ndërmerren **fushata informimi** për publikun ku të promovohen lehtësirat, avantazhet dhe garancitë që standardizimi i profesioneve të rregulluara sjell.
- Në Sllovaki, **krijimi i një baze të dhënash online** për regjistrimin e profesioneve të rregulluara dhe **pika kontakti në administratën** vendore për të ndihmuar e dhënë informacione mbi procedurat ishin tepër të rëndësishme për profesionistët vendas dhe për lehtësimin e procesit.
- **Parapërgatitja dhe njësimi i listave dhe kurrikulave** të profesioneve të rregulluara më ato të BE-së, janë kyçe për të përshpejtuar procedurat në këtë fushë, për të ndihmuar profesionistët vendas dhe për të tërhequr profesionistë nga BE.
- Për një mbarëvajtje të procesit të njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve dhe diplomave duhet një **bashkëpunim i ngushtë dhe i frytshëm** me urdhrat profesional, sindikatat apo shoqatat e ngjashme në vend për profesionet e rregulluara.
- Duhet treguar tepër kujdes edhe për ndalimin e pengesave që mund të ekzistojnë apo krijohen në një moment më të vonë për **konkurrencën e lirë në tregun e punës** për këto profesione, pasi janë rreptësisht të ndaluara dhe është përgjegjësi e shtetit të sigurojë këtë liri.